

VENDIM
Nr. 35, datë 28.1.2000

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË SESIONIT TË SHTATË NDËRQEVERITAR,
SHQIPTARO- GREK, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, INDUSTRIAL, TEKNIK DHE
SHKENCOR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË GREQISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 8371, datë 9. 7. 1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të sesionit të shtatë ndërqeveritar, shqiptaro-grek, për bashkëpunimin ekonomik, industrial, teknik dhe shkencor ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta